

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i krimeve të rënda - kolegji i përberë nga gjyqtarët Fllanza Kadiu, kryetare kolegji, Mejreme Memaj e Hava Haliti, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve F.Sh., nga, komuna e Suharekës, E.Z. e A.Z., që të dy nga Suhareka, rruga “Skënderbeu”, p.n., për shkak të veprës penale vrasje, parashikuar me nenin 146 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës(KPK), duke vendosur përkitazi me ankesat e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarve V.K. dhe Z.K., avokatit H.K., mbrojtësve të të akuzuarve F.Sh., E.Z., A.Z., avokateve E.R., K.K. dhe R.D., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda P.nr.63/2015 datë 18 prill 2016, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale(KPP), me 10 nëntor 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarve V.K. dhe Z.K. dhe ato të mbrojtësve të të akuzuarve F.Sh., E.Z. e A.Z., kurse aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda P.nr.63/2015 datë 18 prill 2016, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda P.nr.63/2015 datë 18 prill 2016, të akuzuarit F.Sh., E.Z. e A.Z. janë shpall fajtor për shkak se si bashkëzekutor kanë kryer veprën penale vrasje, parashikuar me nenin 146 lidhur me nenin 23 të KPK, për të cilën janë gjykuar i akuzuari F.Sh. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 14(katërmbëdhjetë) viteve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 2.08.2012 e tutje, i akuzuari E.Z. e A.Z. secili me dënim burgimi në kohëzgjatje prej nga 12(dymbëdhjetë) viteve në të cilat u është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 11.09.2014 e tutje. Te dëmtuarat V.K. dhe Z.K. për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil. Të akuzuarit janë obliguar që të të paguajnë shpenzimet e procedurës penale, si dhe shpenzimet për paushallin gjyqësor secili nga 1000€.

Kundër këtij aktgjykimi kanë ushtruar ankesa:

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarave V.K. dhe Z.K. avokati H.K., për shkak të vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që ndaj të akuzuarve të shqiptohen dënime me të larta me burgim apo të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së parë për rigjykim;

Mbrojtësi i të akuzuarit F.Sh., avokati E.TH., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që i akuzuari të lirohet nga akuza ose të konstatohet se në veprimet e tij formohen tiparet e veprës penale të mbrojtjes së nevojshme nga neni 8 i KPPK ose të veprës penale të pjesëmarrjes në rrahje, nga neni 155 par.2 të KPK ose të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së parë për rigjykim, si dhe të akuzuarit t'i ndërpritet paraburgimi;

Mbrojtësit e të akuzuarve E. e A.Z. avokatët K.K. dhe R.D. (ankesë të përbashkët), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jotë plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së parë për rigjykim ose të ndryshohet ashtu që të akuzuarit të lirohen nga akuza për veprën penale për të cilën janë shpall fajtor dhe tu ndërpritet paraburgimi.

Gjykata e Apelit e caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPP për të cilën i njoftoj palët. Në seancë prezantuan të dëmtuarat Z.K. dhe V.K., përfaqësuesi i autorizuar i tyre avokati H.K., të akuzuarit F.Sh., E.Z. e A.Z., mbrojtësit e tyre avokatet E.TH., K.K., R.D., ndërsa, Prokurori i Apelit edhe pse i njoftuar me rregull nuk mori pjesë në seancë. Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarve dhe mbrojtësit e të akuzuarve pasi që sqaruan disa nga pretendimet ankimore në ankesa mbështeten propozimet e bëra në to, kurse të dëmtuarat dhe akuzuarit mbështeten mbrojtësit e tyre. Prokurori i Apelit me propozimin e bërë me shkrim PPA/I.nr.457/2016 datë 29.08.2016, ka propozuar që ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarve të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarve tu shqiptohen dënime me të larta me burgim, kurse ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e kësaj çështje penalo-juridike, e studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa, konstatoi se:

-ankesat nuk janë të bazuara.

1. Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Sa i përket kësaj baze ankimore mbrojtësit në ankesa pretendojnë se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nenpar.1.12 lidhur me nenin 370 të KPK, ngase Gjykata në arsyetimin e aktgjykimin nuk ka paraqitur arsye të qarta se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron si të vërtetuara apo të pavërtetuara. Kështu, mbrojtësi i të akuzuarit F.Sh. thekson se edhe pse i mbrojturi i tij

F.Sh. nuk e ka pranuar fajësinë, i njëjti ka pranuar se ka goditur tani të ndjerin B. me një hu, dhe bazuar në këtë gjendje faktike mbrojtja ka kërkuar nga trupi gjykues që bëhet ekzaminimi neuropsikiatrik për të akuzuarin për ta vërtetuar gjendjen mendore të tij në momentin kur i ka ndërmarrë këto veprime duke u thirr në parimin se “përgjegjësia prezumohet ndërsa përgjegjshmëria deklarohet nga gjykata”. Një kërkesë të tillë e ka parashtruar dy herë gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe është refuzuar, ndërsa, herën e tretë kërkesa e tij është injoruar fare ngase nuk është vendosur për të. Një veprim i tillë i gjykatës sipas mbrojtjes është në kundërshtim me nenin 7 të KPP sepse gjykata nuk ka qenë e interesuar saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetoj faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, dhe një gjë e tillë vërtetohet edhe nga fakti se gjykata as në aktgjykim nuk e thekson këtë propozim të mbrojtjes. Me tej mbrojtësi citon diapozitivin e aktgjykimit duke theksuar se një përshkrim i tillë është në kundërshtim me vetveten dhe arsyet e aktgjykimit sepse nga ky përshkrim rrjedh se i ndjeri ka qëndruar prapa shkallëve në mënyrë pasive pa ndërmarrë asnjë veprim dhe që të tre të akuzuarit e kanë goditur të ndjerin në një përlëshje masive duke qëndruar prapa shkallëve. Përveç kësaj gjykata nuk jep arsye se në bazë të cilave provave ka përfunduar se i ndjeri ka qëndruar prapa shkallëve deri sa është goditur nga të akuzuarit, dhe pas goditjeve si u gjet i ndjeri në mes të përlëshjes, dhe në bazë të cilave prova e vërtetoj faktin se i ndjeri B. pas goditjes nga ana e të akuzuarit F. është dridhur dhe ka renë pa ndjenja në tokë. Pastaj, si në dispozitiv por edhe në arsyetim theksohet se që të tre të akuzuarit i kanë shkaktuar shumë plagë edhe pse ekspertët e dëgjuar flasin vetëm për një plagë e cila është shkaktuar në ballë mbi syrin e djathtë të tani të ndjerit e cila është edhe e vetmja plagë vdekjeprurëse, e përveç kësaj gjykata nuk jep arsye as përkitazi me elementin subjektiv të veprës penale se si erdhi në përfundim se i akuzuari veprën e krye me dashje.

Mbrojtësit e të akuzuarve E. e A.Z.t në këtë drejtim shtojnë se konkludimi i gjykatës në arsyetim të aktgjykimit përkitazi me përgjegjësinë penale të të mbrojturve të tyre bazuar në provat e administruara nuk është i drejtë. Kështu, bazuar në provat e administruara si procesverbali mbi shikimin e vendit të ngjarjes, raporti i autopsisë së të ndjerit i kryer nga F.B., raporti i Qendrës emergjente të Spitalit rajonal në Prizren, ekspertiza mjeko ligjore e ekspertit C.M., dëgjimi i eksperteve C.M. dhe F.B., super ekspertiza e kryer nga Departamenti i Mjekësisë ligjore, dëgjimi i kryesuesit të kësaj ekspertize, fotoalbumi konkludimi i Gjykatës se behet fjalë për plagë vdekjeprurëse nuk rrjedh nga këto prova, sepse asnjëra ekspertizë nuk potencon se ka më shumë se një plagë vdekjeprurëse. Pastaj, sipas mbrojtësve gjykata e shkallës së parë u falë besimin dëshmisë së dëshmitareve V.K., Z.K., N.K., Gj.K. V.K. përkundër faktit se këto dëshmi të tyre janë mjaft kundërtënëse të njëanshme sepse që të gjithë janë familjar të ngushtë të ndjerit, ndërsa, dëshmitareve tjerë S.K., I.Sh., Sh.K., N.K. nuk ua falë besimin edhe pse pa dyshim vërtetojnë drejt gjendjen faktike.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara.

Edhe pse arsyet e dhëna në ankesa përkitazi me këtë bazë ankimore me tepër i referohen gjendjes së fakteve, ngase, cilave prova dhe pse gjykata ua ka kushtuar besimin, e cilave jo, madje qoftë ai edhe i gabuar ka të bëjë me gjendjen faktike, e jo përkitazi me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, kjo Gjykatë e shqyrtoi aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me këto pretendime ankimore edhe konform nenit 394 të KPP dhe konstatoi se aktgjykimin nuk përmban shkelje esenciale të pretenduara në ankesa e as shkelje të tjera të

cilat kjo Gjykatë në instancë të dytë i shqyrton detyrimisht, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. Aktgjykimi i kundërshtuar është i qartë dhe konkret, përmban arsye të duhura dhe të drejta mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje juridiko-penale. Në të vërtetë gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjyqimit të kundërshtuar ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar dhe ka dhënë arsye të qarta për vërtetimin e këtillë të fakteve, ka përshkruar rezultatit e procedurës provuese duke arsyetuar se për se disa fakte i merr si të provuara e disa jo. Ndërsa, fakti se gjykata në arsyetim të aktgjyqimit nuk ka dhënë arsye se përse e ka refuzuar kërkesën e mbrojtësit për ekspertizë psikiatrike nuk është e natyrës së tillë për të konkluduar se aktgjykimi përmban mangësi të atilla procedurale që do ta benin të paqëndrueshëm ligjshmërinë e tij. Lidhur me këto pretendime ankimore dhe pretendimeve sa i përket vlerësimit të provave materiale dhe jo matriale dhe dashjen si element subjektiv të veprës penale që në fakt kanë të bëjnë me shumë me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike do të behet fjalë në kuadër të kësaj baze ankimore.

2. Pretendimet përkitazi me gjendjen faktike dhe shkeljen e ligjit penal

Meqë pretendimet ankimore sa i përket gjendjes faktike i referohen edhe shkeljes së ligjit penal, kjo Gjykatë që të dyja këto baza ankimore do t'i vlerësoj si një tersi.

Përkitazi me gjendjen faktike mbrojtësit e të akuzuarve pothuajse të gjithë në këtë drejtim i kontestojnë konkludimet e gjykatës në bazë të provave të administruara. Kështu, sipas mbrojtësit të të akuzuarit F.Sh. në këtë çështje nuk është kontestuese fakti se ditën kritike ka ndodhur një përleshje masive në mes të familjes së N.K.t në një anë, J.K. dhe I.Sh. në anën tjetër. Se në këtë përleshje janë përdorur mjete të forta, ndërkaq i akuzuari F.Sh. ka përdorur një hu me të cilin e ka goditur tani të ndjerin B. në tepe të kokës dhe se pas goditjeve të tjera tani i ndjeri vdes, mirëpo, nuk është vërtetuar se shkak i vdekjes i tani të ndjerit B. është njëra prej goditjeve të cilën e ka marrë nga akuzuari F., dhe konstatimi i gjykatës në këtë drejtim nuk ka mbështetje në asnjë provë. Ngase, shkak i vdekjes sipas eksperteve mjeko ligjor është plaga në anën e djathtë mbi sy e cila plagë nuk i vihet në barrë të akuzuarit, ngase goditja e të akuzuarit ka shkaktuar hematomë në kokë, e cila nga ekspertët mjeko ligjor konsiderohet lëndim i lehtë trupor. Po ashtu nuk është vërtetuar se i ndjeri ka pësuar shumë plagë, ngase ekspertët mjeko ligjore kanë konstatuar vetëm një plagë dhe atë në ballin mbi syrin e djathtë. Përveç kësaj sipas mbrojtësit i akuzuari është përfshi pa fajin e vet në atë përleshje, në të cilën babai i tij I. ka qenë i përgjakur, vet i sulmuar nga shumë persona por edhe nga i ndjeri B. dhe në kuadër të kësaj gjendje faktike në veprimet e tij nuk qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar. Duke pasur parasysh se i akuzuari F. dhe babai i tij I. kanë shkuar në vendin e ngjarjes pas telefonatës që e kanë marrë paraprakisht, e kanë njoftuar policinë është e pabesueshme se kanë shkuar në vend të ngjarjes për tu përleshur. Vet fakti se i akuzuari F. ka hyrë në shtëpinë e J., ndërsa babai i tij I.Sh. ka shkuar të motra duarthatë tregon se ka shkuar miqësisht për tu marrë vesh, ndërsa për shkak të gjendjes së acaruar me herët, kërcënimeve nga ana e djemve të N. se do ta vrasin B. papritur babai i të akuzuarit është sulmuar, ndërsa, i akuzuari F. duke dëgjuar britmën ka dal jashtë e ka parë babanë e tij të përgjakur dhe duke dashur t'i ndihmoj të njëjtit është goditur, sulmuar nga pala tjetër, e edhe nga ana e tani të ndjerit me një hu, të cilin ka arritur t'ia marrë nga dora dhe e ka goditur të ndjerin vetëm njëherë në tepe të kresë. Në kuadër të kësaj gjendje mbrojtësi pretendon se veprimet e tij kanë qenë të nevojshme dhe të domosdoshme për ta zbrazur sulmin e atëçastshëm dhe të kundërligjshëm, pra, në veprimet e tij formohen të gjitha elementet e veprës penale mbrojtje e nevojshme nga neni 8 i KPK. Në rast se gjykata

konsideron se i ndjeri B. ka vdekur pas goditjeve të shumta në një përleshje masive dhe në këtë përleshje i akuzuari F. e ka goditur të ndjerin atëherë nuk kemi të bëjmë me veprën penale të vrasjes për të cilën ngarkohet i akuzuari por të pjesëmarrjes në rrahje nga neni 155 par.2 të KPK. Si pasojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike mbrojtësi pretendon se është shkelur edhe ligji penal në dëm të të akuzuarit.

Edhe mbrojtësit e të akuzuarve A. e E.Z. në ankesën e tyre të përbashkët kontestojnë konkludimet të cilat i ka nxjerrë gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të administruara. Duke konsideruar se dëshmitë e dëshmitareve të dëgjuar në këtë çështje sidomos atyre dëshmitare që ua ka falur gjykata besimin janë kontradiktore. Kështu, sipas ankesës në këtë çështje janë dëgjuar gjashtë dëshmitar –anëtar të familjes së N.K.t dëshmitë e të cilëve janë kontradiktore me njëra -tjetrën në të gjitha fazat e procedurës (mbrojtësit kanë elaboruar dëshmitë e këtyre dëshmtuarve të dhëna në hetime, në shqyrtimin gjyqësor dhe rigjykim), mirëpo, janë dëgjuar edhe gjashtë dëshmitar të familjes së J.K. të cilët dëshmojnë pafajësinë e të akuzuarve dhe tre dëshmitar të familjes Sh. të cilët po ashtu nuk i inkrimojnë të akuzuarit. Pastaj, sipas ankesës as nga provat materiale nuk rezulton të jetë e vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Ngase sipas ekspertit C.M. i cili është dëgjuar në rigjykim përkitazi me natyrën e lëndimeve të të ndjerit derisa ishte gjallë kemi të bëjmë me një plagë vdekjeprurëse, dhe kjo plagë ka mundur të reflektoj me presion në pjesët fqinje dhe të ndryshojë strukturën si të kockave ashtu edhe të trurit. Pastaj, edhe eksperti F.B. i cili e ka përpiluar raportin e autopsisë i dëgjuar drejtpërsëdrejti në rigjykim ka theksuar se “ plaga në regjionin ballor të kokës e shoqëruar me thyerje të kockave ballore (pra një plagë dhe shumë thyerje) padiskutueshëm se është plagë vdekjeprurëse, sepse zhytja e kockave në indin trunor(pra kockat e thyera kanë prekur indet trunore të cilat pastaj kanë shkaktuar gjakderdhje në pjesë të ndryshme të trurit), ndërsa, thyerja e kockave të hundës dhe e sinusit nuk mund të prek indet trunore, prandaj as kjo, e asnjëra nga hematomet të cilat nuk janë plagë fare nuk kanë mundur të shkaktojnë vdekjen. Pasta, edhe super ekspertiza të cilën e kanë përpiluar tre ekspert me shkrim është absolutisht e njëjtë me raportin e autopsisë, ku sipas kësaj ekspertize mjekët përshkruajnë si shkak të vdekjes një dëmtim-plagë vdekjeprurëse. Kurse, kjo plagë sipas mbrojtësve bazuar në provat e administruara është shkaktuar nga goditja me çekiç apo goditja e shkaktuar nga F.Sh., por nuk është shkaktuar nga të akuzuarit E. e A. . Kurse, si pasojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike edhe këta mbrojtës pretendojnë se është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarve. Në fakt sa i përket kësaj baze ankimore bazuar në gjendjen faktike pretendohet se kemi të bëjmë vetëm me lëndim të rëndë trupor me pasojë vdekje të shkaktuar nga ana e të akuzuarit F. ndaj të ndjerit.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara.

Sipas mënyrë se si është zhvilluar ngjarja nga shkresat e shkresave të lëndës nuk rezulton kontestuese se ngjarja tragjike ka ndodh me 2.08.2012, rreth orës 16 e 30 min., në rrugën “Skënderbeu”, përballë shtëpisë së N.K.t e J.K.; dhe se që të gjithë personat që ishin të involvuar në këtë ngjarje janë në raporte të ngushta familjare. Në fakt në këtë ngjarje ishin të involvuar anëtarët e tri familjeve -djemtë e J.K.E, E., A., D. e A. dhe djemtë e N.K. - M., F., Nj., B. e B.I. dhe miku i tyre I.Sh. me djemtë F.in dhe B.; N. e J. janë vëllezër, bashkëshortet e tyre janë motra, kurse I. Sh. është miku i tyre, përndryshe vëllai i bashkëshortëve të N. e J., kurse F. është djali i I.t.

Nuk rezulton kontestues as fakti se si shkas i kësaj ngjarje është mos pjesëmarrja e familjes se J. dhe I.Sh. në dasmën e djalit të N.t dhe provokimit të dasmorëve nga familja e I.t dhe J. sipas thënieve të N.K.t. Të nesmren pas dasmës N.K. nëpërmjet I.Sh. - kushëritit të bashkëshortes së tij dhe njërit nga djemtë e tij i dërgon porosi I.t “që të mos vjen se po provokon dhe puna do të behet keq”. Edhe pse, sipas dëshmisë se I.Sh. në momentin kur ia kishte dërguar porosinë I.t kanë qenë prezent F.i e B., pas dërgimit të kësaj porosie pas dy tri orëve në shtëpinë e J.K. shkon B.Sh... Meqë djemtë e N.t e shohin B. vjen deri të një konflikt verbal në mes tyre. Djemtë e N.t mbi murin që ndan oborret e shtëpisë se N.t dhe J.i i thojnë B. “se pse ke ardh këtu”, por, situata qetësohet. Mirëpo, ngjarja tragjike rezulton pas thirrjes së I.t nga motra e tij-bashkëshortja e J., i cili e merr djalin e tij F.in dhe ndalet para shitores se djemve të N. ku po qëndronin M. e F. , dhe fillimisht fillon një përlëshje fizike mes tyre, në të cilën inkuadrohen edhe të tjerët. Gjatë përlëshjes fizike si pasojë e lëndimeve të pësuar humb jetën B. K. -djali i N.K.t dhe të tjerët pësojnë lëndime të shkaktuara ndaj njeri- tjetrit. Nuk është kontestuese as fakti se sipas raportit të autopsisë – vdekja e të ndjerit është e dhunshme si pasojë e dëmtimit të trurit e shoqëruar me gjakderdhje në zona të ndryshme trunore, e që janë rrjedhojë e thyerjeve të shumta të të kafkës nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë).

Përkritazi me të involvuarit tjerë në këtë çështje tani të dënuar -E.K., Mehdi K. e F.K., F.K., Nj.K., D.K. I.Sh., J.K..(ndaj J.K.. Prokurori heq dorë nga ndjekja penale për veprën penale të vrasjes),e B.Sh.. çështja ka marrë formë të prerë nga kjo Gjykatë, mirëpo, sa i përket të akuzuarve F.Sh., E. Sh. e A. Sh. për veprën penale të vrasjes, nga neni 146 lidhur me nenin 23 të KPK –çështja është kthyer në rigjykim. Kjo Gjykatë e theksoj këtë fakt meqë tani subjekt të shqyrtimit të aktgjykimit të kundërshtuar janë vetëm të akuzuarit F., E. e A., dhe çështja është anuluar me sugjerimin që të behet super ekspertizë në mënyrë që të përcaktohet plaga vdekjeprurëse dhe mjetet e goditjes.

Në rigjykim rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vepruar sipas vërejtjeve të kësaj gjykate duke urdhëruar super ekspertizë. Me ç’rast, grupi prej tre eksperteve i përberë prej Dr. N.U., F.D. dhe V.K. bazuar në raportin e autopsisë, përshkrimin e plagëve nga raportet mjekësore të Spitalit Rajonal të Prizrenit dhe QKUK - Klinikës së Anestiozologjisë dhe Mjekimit intensiv kanë konkluduar me besueshmëri të lartë shkencore se: **gjendja** e të ndjerit nga pranimi e deri në vdekje, sipas raporteve mjekësore nga Spitali i Prizrenit dhe QKUK, ka qenë gjendje komatoze- e pavetëdijshme; **mjetet** me të cilat është goditur i ndjeri konsistojnë në mekanizmin e veprimit të mjeteve të forta mbretëse, pa maje dhe jo të mprehta; **plagët vdekjeprurëse** konsistojnë me plagët – thyerjet në regjionin e djathtë ballor të kokës dhe thyerjet e sinusve ballor, mollëzor dhe sfenoidal të anës së djathtë; **shkaku i vdekjes** – në rastin konkret ka qenë gjakderdhja e brendshme trunore, si rrjedhojë e thyerjeve të shumëfishta të kockave të kafkës dhe bazës së kafkës. Eksperti mjeko-ligjor Dr. N.U. është dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor dhe ka mbetur pranë mendimit dhe konstatimit të dhënë me shkrim. Duke shtuar se behët fjalë për dy grupe të plagëve, njëra nga grupi i plagëve janë thyerjet në regjionin e djathtë ballor të kokës, grupi tjetër i plagëve janë thyerjet e sinuseve ballor mollëzor dhe sfenoidal, dhe këto plagë në të shumtën e rasteve janë shkaktuar nga me shumë se një goditje, duke shtuar se thyerjen e shumëfishtë të kockave ballore e kanë përshkruar në grupin e plagëve vdekjeprurëse pa e cilësuar apo klasifikuar a ka qenë zhytëse apo jo, meqë është plagë vdekjeprurëse, dhe ka përsëritur se kemi të bëjmë me dy grupe plagësh vdekjeprurëse. Kurse, përkritazi me hematomat –gjak mbledhjet nën lëkurore të

përshkruara në raportin e autopsisë si fenomeni i syzave ka theksuar se janë pasojë e thyerjes së bazës së kafkës dhe është karakteristikë tipike e lëndimeve që pasohen me gjak mbledhje përreth dy syve. Eksperti i cili e ka bërë autopsinë e të ndjerit –dr.F.B. kur është gjykuar kjo çështje për herë të parë në shqyrtimin gjyqësor nuk e ka përcaktuar plagën vdekjeprurëse dhe as mjetet e goditjes. Sipas këtij eksperti të gjitha dëmtimet që i ka pësuar i ndjeri nuk ka qenë e mundur të jenë shkaktuar nga veprimi vetëm i një mjeti të fortë, me besueshmëri të lartë shkencore duhet të kenë qenë me shumë. Lloji i mjetit nuk ka mund të përcaktohet sepse i ndjeri ka qenë i shtrirë një javë në qendrën Klinike dhe një pjesë e plagëve është shëruar, kurse edhe goditja vdekjeprurëse është vështirë të përcaktohet sepse goditja pasuese e ka ndihmuar thyerjen e një pjesë të kafkës dhe është logjike se disa prej goditjeve në kokë kanë vepruar në mënyrë kumulative dhe kanë ndikuar jo vetëm në thyerje të kafkës por edhe në gjakderdhje trunore. Përkundër këtij fakti, gjykata çuditërisht e dëgjon përsëri këtë ekspert në rigjykim, i cili edhe pse e mbështet konstatimin e përpiluar me shkrim të raportit të autopsisë si dhe deklarimin e tij në seancën e datës 23.10.2013, tani shton se behet fjalë për një plagë vdekjeprurëse. Sipas këtij eksperti plaga në regjionin ballor të kokës e shoqëruara me thyerje zhytëse të kockave ballore dhe me dëmtim të trurit në zonën përkatëse është padiskutim dëmtim masiv dhe është **vdekjeprurës**, sa i përket frakturës së bazës së kafkës nuk përjashtohet mundësia që të ketë qenë faktor kontribuues ndihmës në ardhjen e vdekjes por kjo është e padiskutueshme sepse kemi dëmtim të strukturave trunore, dëmtimi në hundë - thyerja e kockave të hundës dhe e sinusit maksillar nuk prek indin trunor sepse është jashtë trurit prandaj si i tillë nuk ka qenë vdekjeprurës, edhe hematoma në anën e majtë nuk ka qenë vdekjeprurëse. Siç del nga shkresat e lëndës pas ngjarjes i ndjeri ka qëndruar në gjendje kome një javë. Gjatë kësaj kohë është bërë ekspertizë mjeko- ligjore përkitazi me natyrën e lëndimeve të shkaktuara ndaj tij, e cila ekspertizë është bërë me 8.08.2012 nga Dr.C.M.. Në rigjykim del se gjykata e ka dëgjuar edhe këtë ekspert i cili e ka mbështetur mendimin dhe konstatimin e tij të bërë me shkrim. Duke shtuar se bazuar në materialin morfologjik traumatik në indet e forta dhe ai klinik në indet e buta lëndimet e tilla ky ekspert i ka kualifikuar si lëndime të rënda trupore të rrezikshme për jetë në momentin e shkaktueshmërisë, me dobësim të përhershëm të aktiviteti fizik për pjesën e atakuar. Këtë mendim e ka bazuar në raportin e Spitalit regjional përkatësisht Emergjencës në Prizren. Me tutje sipas ekspertit sipas të dhënave ekzaminuese në kokë nga mjeku emergjent përshkruhet një plagë në regjionin ballor, hematom ose infiltrim nënlekuror përreth orbitës së djathtë të shoqëruara me gjakderdhje në syrin e djathtë, këtu diametrat janë dhënë 3cm x 05cm nuk kemi dimensione të sakta të hematomat përkatësisht infiltrimit nënlekuror të gjakut në këtë regjion dhe e gjithë kjo vështirëson mendimin mbi numër të tjetër të plagëve **dhe i gjithë favori shkon te koncentrimi i vetëm i një plage** dhe kjo plagë ka mund të reflektoj me presion në pjesët fqinje dhe të ndryshoj strukturën si të kockave ashtu edhe të trurit, dhe si shufra e hekurit dhe si shufra e drurit nëse ka qenë nën ndikimin e fuqisë së sulmuesit ka mund të shkaktoj këto plagë që janë përshkruar në lekure, kocka dhe inde. Sipas listës së dëshmimeve rezulton se në vendin e ngjarjes janë gjetur: një çekan i ngjyrës së zezë, një shishe plastike me njolla gjaku, një fshesë me bisht të gjatë, një fshesë me ngjyrë të zezë, një copë druri, dy copa druri të bishtit të fshesës, një dru rreth 2 metra të gjatë, një dru rreth 1.5m i gjatë, një dru 80cm i gjatë, një shami për femra në vendin e ngjarjes dhe pesë telefona mobil.

Edhe pse ngjarja ka ndodhur në vend publik para dyerve të shtëpisë të vëllezërve J. e N., i vetmi dëshmitar okular në këtë çështje është Rr.H., i cili e ka parë ngjarjen por nuk ka dhënë detaje se kush – kënd ka sulmuar, kurse që të gjithë dëshmitarët tjerë në këtë ngjarje

janë anëtar familjar qoftë të të ndjerit qoftë të të akuzuarve. Kështu, dëshmitarët si B.K., Xh.M. dhe H.K. nuk kanë dhënë detaje rreth rastit. Dëshmitari I.Sh. ka dëshmuar përkitazi me faktin se ditën kritike me kërkesën e N.K.t se bashku me njërin nga djemtë e tij kishte shkuar tek I.Sh. për ta përcjell porosinë “se mos ejani me provoku se puna behet keq”, kurse dëshmitari N.K.1. ka dëshmuar se ditën kritike kishte takuar I.n dhe F.in i kishte marrë me automjet dhe i kishte zbritur diku 30m para dyerve të shtëpisë së të dy familjeve K., kurse edhe pse ka deklaruar se e ka pa ngjarjen nuk ka dhënë detaje rreth ngjarjes. Kurse, dëshmitarja V. K. – bashkëshortja e të ndjerit në dëshminë e saj që nga fillimi i procedurës ndër të tjera ka dëshmuar se “pas zhurmës që kishte dëgjuar kishte dal jashtë dhe kishte parë tri familjet duke u përlesh në mes veti, kurse në ato momente i kishte shkuar mendja tek burri i saj – i ndjeri të cilin e kishte parë duke qëndruar në anën e rrugës në këmbë, dhe pastaj kishte parë kur J. me çekan me bisht të shkurtër në dorë (në hetime ka deklaruar me një mjet në bisht në dorë), i cili kishte shkuar në drejtim të të ndjerit dhe e kishte goditur në kokë, por në cilën pjesë të kokës nuk e dinte, pas tentimit që të shkonte tek burri i saj dikush e kishte tërhequr prapa dhe ishte alivanosur, pasi që ishte këndellur e kishte kërkuar djalin e saj dhe pasi që e kishte parë kishte dal përsëri, kishte parë E.in me një mjet të gjatë në dorë (1m) por a ka qenë i drurit apo i hekurit nuk e din me të cilin e kishte goditur B.in i cili në ato momente qëndronte në mes të turmës. Sipas saj bashkëshorti i saj nuk është rrëzuar pas goditjes të cilën e kishte marrë nga J., por as kur e kishte godit E.i, ndërsa, kur është rrëzuar nuk e kishte parë”. Dëshmitarja V.K. – motra e të ndjerit, e cila sipas shkresave të lëndës ka qenë terë kohen në ngjarje kur është gjykuar kjo çështje herën e parë nuk është dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor, në dëshminë e saj në rigjykim ndër të tjera ka deklaruar “se J. e kishte goditur të ndjerin me çekiç në pjesën djathtë të syrit, F.in e kishte parë me një dru të trashë por nuk e kishte parë kur e kishte goditur vëllain e saj të ndjerë, kishte vërejtur E.in me një dru të trashë kur e kishte goditur B.in në kokë në afërsi të veshit si dhe A.in kur e kishte goditur pasi që i ndjeri kishte renë në tokë në pjesën ka hunda dhe ballë, por mjetin me të cilin e ka goditur nuk e kishte vërejtur, por ka dëgjuar kur i është drejtuar me fjalët “ mos vdeksh këtu kam me të mbut në Itali “. Z.K. – nëna e të ndjerit në dëshminë e saj pasi që përshkruar rrjedhën e ngjarjes deri në momentin kritik ka theksuar se që të tre të akuzuarit kanë pas mjete të forta. F.i e kishte goditur të ndjerin me një dru të trashë në kokë dhe në pjesë të ndryshme të trupit, dhe i ndjeri ka qëndruar pas goditjes, E.i i kishte sjell në kokë me hekur i cili ka qenë në formë të “shipkës”, dhe edhe A.i me një dru në dorë e kishte goditur B.in në të gjitha pjesët dhe i kishte thënë “mos vdeksh ktu të mbysë në Itali”. N.K. – babai i të ndjerit i cili në rigjykim është dëgjuar në cilësi i të dëshmitarit ka deklaruar “se një ditë para ditës kritike e kishte martuar djalin dhe edhe pse të ftuar as vëllai i tij J. me familje dhe as miku i tij I. nuk kishin marrë pjesë në dasmë. Madje, ditën e dasmës ata kishin provuar duke i parkuar automjetet para shtëpisë me qëllim të pengimit të marrjes së nuses. Për shkak të kësaj shtate të nesmren I.t – mikut të tij ia kishte dërguar I.Sh. që t’ia dërgojë një porosi me qëllim të qetësimit të situatës. Përkundër kësaj B. atë ditë kishte ardhur në shtëpinë e J. dhe kishte goditur dyert e shtëpisë. Djemtë e tij i kishin thënë se “si u bo babë që t’i dërgove njerëz dhe ata erdhën prap e na provokuan” Ka bërë përpjekje për t’i qetësuar djemtë e tij që të kalojnë mbi murin që ndan oborret e shtëpisë se N.t dhe J., dhe i kanë thënë B. “se pse ke ardh këtu” . Brenda kësaj kohe kanë shkuar në shtëpinë e tij djemtë e J. A., Ethem i D. por ka arritur që ta qetësoj situatën. Për tu larguar nga kjo situatë ju kishte thënë djemve që të shkojnë në bjeshkë. Situata kishte eskaluar pas ardhjes së I.t dhe F.it. Kishte qenë në bodrum se bashku me të ndjerin dhe me të dëgjuar zhurmën kanë dal jashtë. F. dhe M. kanë qenë në

shitore. Pasi që kanë dal jashtë i ka parë të gjakosur djemtë e tij M. dhe Nj., i ndjeri kishte bërë përpjekje t'i ndihmoi vëllait të tij dhe gjatë kësaj përpjekje i kishte mëshuar F.i me një dru në kokë, të ndjerin e kishte godit edhe E.i me një dru të gjatë 1.5m në anën e djathtë të kokës, dhe A.i i cili kishte qenë i pajisur me një hebell". Gj. K. – bashkëshortja e M.-djalit të N.t, në dëshminë e saj ka deklaruar se "pasi që kishte dal jashtë kishte pa rrëmuje dhe ishte tmerruar. Kishte parë J.n me çekiç në dorë, i cili e kishte goditur të ndjerin në kokë, E.in me një hekur në dorë, F.in me një dru dhe A.in e cili kishte pas në dorë një dru të trashë, dhe që të katërtit e kishin goditur të ndjerin në kokë, kurse i akuzuari A. i kishte "thenë mos të mbytshta këtu kam me të mbutë në Itali". Kurse, dëshmitarja K. K. – bashkëshortja e B. K.t – djalit të N.t, në dëshminë e saj deklaroi se ditën kritike kishte parë kur E.i e A.i e kishin kapur të ndjerin duke i mëshuar dhe tërhequr për duar, E.i me F.in kishin në dorë nga një dru. Në këtë çështje siç është thënë edhe me lartë janë dëgjuar edhe familjarët e të akuzuarve E. e A.Z.. Kështu, N.K. – nëna e të akuzuarve në dëshminë ndër të tjera thekson "se ditën kritike tek kishte shkuar B. -djali i vëllait, kishte dëgjuar një zhurmë nga oborri i kunatit, kurse djemtë e tij kishin hipur mbi muri dhe i kishin thënë "O B. dil ko se dojna me ë mbyt, kena me të pre", dhe për të mos ardhur deri tek konflikti djemt e saj kishin shkuar tek mixha i tyre, ndërsa, B. kishte kërkuar nga ajo që ta thërriste në telefon I.n të cilin e kishte thirrur. Pas disa minutave kishte dëgjuar një zhurmë. Kur kishte dal jashtë e kishte parë I.n të përgjakur, F.in të përgjakur, M. të përgjakur, kishte parë edhe F.n por jo të përgjakur. Në momentin kur F.i e kishte parë babain e tij të përgjakur e kishte kap një dru të cilin e kishte qar përpjetë, pastaj kishte dëgjuar një krismë dhe B.i kishte rënë në tokë. Sipas saj, ditën kritike jashtë prej djemve të saj kishte qenë vetëm A., kurse J. në ato momente nuk kishte qenë por kishte ardh në fund me një çekiç të arrave në dorë". Kurse, S.K. – bashkëshortja e A.t – vëllait të të akuzuarve A. e E., ka deklaruar se "ditën e ngjarjes F.i kishte pasur në dorë një shati-hekur me të cilin e kishte goditur B.in – të ndjerin njëherë në kokë (në shqyrtimin gjyqësor të vitit 2013 ka deklaruar se ka pas në dorë në bisht shati i cili ka pas një çyk i cili e kishte godit B.in i cili pas kësaj goditje është dridh dhe kishte ra në tokë – ciment). Përveç V. të ndjerit askush nuk ju kishte afruar, kurse E. ishte me B.n i cili kishte në dorë një dru dhe të cilit E.i i thoshte që ta lëshonte, kurse B. e kishte kafshuar në krah, kurse A.i në ngjarje kishte ardh në momentin kur kishte filluar përleshja. Kurse, vajza e të akuzuarit E.Z.t – Sh.K. ka theksuar faktin se i ndjeri është goditur nga F.i me një dru – 1.5cm, ndërsa, babai i saj në momentin kur kishte dal jashtë ka qenë afër asaj dhe nuk ka pas kontakt fizik me të, ndërsa, A.i nuk kishte qenë prezent hiq kur kishte ndodh rasti. Dëshmitari okular Rr.H.j i cili edhe në rigjykim nuk ka mund të dëgjohet kurse deklarata e tij e dhënë në hetime me pëlqimin e palëve është lexuar në dëshminë e tij ndër të tjera ka theksuar "se me të kthyer prej restorantit "NN" në rrugën e **Rreshtanit** pikërisht në anën e majtë ka parë një tollovi. Fillimisht ka menduar se behët fjalë për dasëm, por kishte vërejtur se disa perona ishin të gjakosur, sidomos njeri prej tyre për të cilin më vonë kishte kuptuar se është nga fshati **Peçan**. Pasi që kishte ndal makinën dhe kishte zbritur është nisur në drejtim të tyre për t'i ndarë, mirëpo është ndal para vendit të ngjarjes sepse personat e involvuar në rrahje kishin filluar të gjuajnë me shishe të birrave. Në ngjarja kanë qenë të involvuar 12 të ri, dy pleq, njeri prej tyre quhet J. të cilin e njihje, dy plaka, dy gra tjera, vajza dhe fëmijë. J. ka pas një çekiç të vogël në dorë me ngjyrë të zezë(dorëza e çekiçit e gjatë diku 30cm) zakonisht ky lloj çekiç në ndërtimtari përdoret për të ngulur gozhda. Ajo që i kishte mbet në kokë është fakti se çekiçi pjesën me të cilën e godet gozhdën e kishte të rumbullakët. Një person ka pasur thikë të gjatë e cila i ngjasonte thikës së kuzhinës, nuk ka mundur të vërej se çfarë dorëze kishte, të

tjerët kanë pasur shishe nëpër duar, nga ana e djathtë e ime personat gjuanin me shishe të birrës në drejtim të kundërt. Ka qenë një ngjarje kaotike nuk ka mundur të dalloj palët kundërshtarë, ka pas edhe mjete të forta si hunj për mbajtjen e fidanëve. Kam parë një person të shtrirë në tokë pa shenja jete, edhe një person të gjakosur i cili ka qenë në këmbë e më vonë është ulur në anën e majtë të dyqanit, disa persona i janë afruar personit i cili ishte i shtrirë pa shenja jete në tokë, a e kanë përçafu a e kanë godit nuk e din, s'ka pas mundësi t'i shoh. Nuk ka mund të dëgjoj asgjë, fëmijët qanin, bërtisnin, vajzat gjëmonin, mund të them që të gjithë kanë qenë të involvuar në rrahje pos një vajze e cila ka tentuar që ta pengonte një djalë i cili mendohej me e nxjerrë një hu me të cilën rrethohen fidanët e pemëve. Në momentin kur kishte zbritur nga makina nuk e kishte parë personin pa shenja jete të shtrirë në tok. Ka bërë përpjekje që ta thërras policinë dhe kur është kthyer nga vendi i ngjarjes e pikërisht në krahun e djathtë të dyqanit të ushqimores ky person ka qenë i shtrirë në tokë dhe nuk ka mund me pa kush e ka godit. Në rigjykim i akuzuari F.Sh. e pranon faktin se e kishte godit të ndjerin me një hu rreth 2m të gjatë dhe të trashë sa dora e tij(për herë të parë kur është gjykuar kjo çështje e ka mohuar një fakt të tillë). Sipas këtij të akuzuari për faktin se para ngjarjes në shtëpinë e tyre kishte shkuar I.Sh. të cilin e kishte dërguar N. (daja i tij) vëllai i tij B. nuk kishte njohuri ngase kishte qenë aty, mirëpo, pasi që kishin marrë një telefonatë nga familja e J. “ se po dojnë me e vra B. djemtë e N.” në atë moment e kishte lajmëruar policinë, ndërsa, së bashku me babanë e tij ishte nisur në këmbë që të shkojnë që të shikojnë se çfarë është duke ndodhur. Rrugës ishin takuar me N.K.1 i cili i kishte marrë me makinë dhe i kishte dërguar deri në afërsi të 30m larg shtëpisë së N.. Pasi që janë ndalur vet kishte hyrë në livadhin e J., ndërsa, babai i tij ishte nisur tek shtëpia e N.t për të biseduar me të njëjtin. Për një moment ka dëgjuar një bërtitme të babait dhe pasi kishte dal në rrugë kishte parë babanë e tij të shtrirë në rrugë dhe të përgjakur, ndërsa afër tij djemtë e N. –M., Nj., B., B.1., B.i, F. e K. të cilët posedonin mjete në duar, me tu afruar në vendin e ngjarjes Nj. e kishte goditur me një letfë të gjatësisë 50-60 cm, F. me një gyp ku ka renë në tokë kurse me të ngritur në këmbë i ndjeri e ka goditur me një hu rreth 2 m të gjatë me trashësi sa dora e tij dhe pasi që është goditur nga ai të njëjtit ia kishte marrë hunin nga dora dhe e kishte goditur të ndjerin në pjesën e kokës –mes të kokës dhe në momentin e goditjes i ndjeri ka qenë në këmbë por nuk e ka parë momentin kur është rrezuar. Përpara se të dëgjohej ky i akuzuar mbrojtësi i tij avokati E.R. duke pretenduar se i mbrojturi i tij veprimet e tij i ka ndërmarrë pasi që e ka parë babain e tij të përgjakur dhe vet është sulmuar i ka propozuar gjykatës i akuzuari të dërgohet në ekzamimin psikiatrik që të përcaktohet aftësia e tij për t'i kuptuar veprimet e tij nën rrethanat e ngjarjes, të cilin propozim gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar. Ndërsa, që të dy të akuzuarit E. e A. i mohojnë veprimet e tyre inkrimuese. I akuzuari E. thekson se në vendin e ngjarjes kontakti i tij i vetëm ka qenë me B.n, por i kujtohet që F.i ka bërtit dhe kur është kthyer mbrapa ka parë që F.i e kishte goditur të ndjerin në kokë i cili menjëherë ka renë në tokë, kurse i akuzuari A. deklaroi se kur kishte dal jashtë ka parë një tollovi duke u rrahur dhe sharë në mes veti. Kishte parë të ndjerin B. në anën e djathtë të tij F.in të cilët kanë qenë duke u kacafytur me fjalë “o kom me të hangër” dhe shumë të nervozuar dhe në atë moment ka shkuar drejt Nj. dhe F.t të cilët ishin duke e goditur B. dhe pas pak kishte ardhur policia.

Bazuar bë ketë gjendje të fakteve kontestuese sipas mbrojtësve të të akuzuarve janë faktet:

1. Se kemi të bëjmë me një plagë vdekjeprurëse e cila nuk është shkaktuar nga goditja e të akuzuarve (sipas pretendimeve pretendohet se kjo plagë është shkaktuar nga goditja e të ndjerit me çekiç)?

2. Se në bazë të provave të administruara nuk është provuar se të akuzuarit E. e A. i kanë ndërmarrë veprimet inkriminuese si në dispozitiv të aktgjykimit dhe se në rastin konkret kemi të bëjmë vetëm me lëndim të rëndë trupor me pasojë vdekje të shkaktuar nga i akuzuari F.Sh., kurse sipas pretendimeve të mbrojtësit të të akuzuarit F. ky i akuzuar ka vepruar në mbrojtje të nevojshme apo në veprimet e tij qëndrojnë elementet e veprës penale të pjesëmarrjes në rrahje nga neni 155 i KPK?

Kjo Gjykatë pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura konkludon se :

Se pari, bazuar në provat materiale mendimet dhe konstatimet e eksperteve mjeko ligjore në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një plagë vdekjeprurëse ashtu siç pa bazë pretendohet në ankesa. Në të vërtetë qëndron fakti se sipas ekspertit Dr.C.M. dhe F.B. behet fjalë për një plagë vdekje prurëse, mirëpo sipas ekspertizës të kryer nga grupi i tre eksperteve nuk rezulton se kemi të bëjmë me një plagë vdekjeprurëse. Duke pasur parasysh faktin se eksperti C.M. mendimin e tij përkitazi me natyrën e lëndimeve të të ndjerit e ka dhënë gjatë kohës sa i ndjeri ishte gjallë- në gjendje komatoze në spital, kurse, eksperti Dr. F.B. i cili e ka bërë autopsinë e të ndjerit kur është gjykuar për herë të parë kjo çështje me rastin e dëgjimit të tij në shqyrtimin gjyqësor nuk e ka përcaktuar plagën vdekjeprurës dhe as mjetet me të cilat është goditur i ndjeri, kjo Gjykatë mendimin dhe konstatimin e bërë prej tre eksperteve e konsideron si zgjidhje objektive të kësaj çështje. Ngase konstatimi dhe mendimi i tyre se tek i ndjeri janë shkaktuar dy lloj plagësh vdekjeprurëse – thyerjet në regjionin e djathtë ballor të kokës dhe thyerjet e sinusve ballor, mollëzor dhe sfondial të anës së djathtë të cilat janë shkaktuar nga veprimi i mjeteve të forta mbretëse, pa maje dhe jo të mprehta është në harmoni me parimet shkencore dhe përvojën e tyre profesionale dhe bazuar në raportin e autopsisë së bërë tek i ndjeri, raporti i Qendrës Emergjente në Prizren dhe Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë. Ndërsa, është fakt se sipas dëshmitarëve të dëgjuar i ndjeri është goditur me çekan në kokë edhe nga J.K., mirëpo, përkitazi me këtë të akuzuar Prokurori ka heq dorë nga akuza prandaj, kjo Gjykatë se sheh të nevojshme të bëjë vlerësime në këtë drejtim.

Së dyti, sipas shkresave të lëndës është jokontestuese se pasi që N.K. përmes I.Sh. i çon fjalë mikut të tij I.t se “ mos të vjen se puna do të behet keq”, i cili fakt vërtetohet jo vetëm nga N. por edhe nga vet dëshmitari, tek J. shkon B.Sh.. për çka vjen deri të një fjalosje verbale në mes të djemve të N.t dhe djemve të J. për këtë shkak. Pas njoftimit me telefon përkitazi me këtë fjalosje shkon edhe I. me djalin e tij F.in të cilët siç del nga shkresat e lëndës ndalen para shitores së djemve të N. me çrast fillon menjëherë përleshja fizike fillimisht në mes I.t dhe F.it dhe dy djemve të N. në të cilin përleshje inkuadrohen edhe të tjerët, e edhe të akuzuarit E. e A.. Nuk ka asnjë provë apo indikacion në shkresa të lëndës se I. kishte shkuar për tu marrë vesh me N., dhe se F. kishte hyrë në shtëpinë e J. kurse gjatë rrugës ata kishin lajmëruar policinë. Në fakt i akuzuari F. kur është dëgjuar për herë të parë në polici nuk ka theksuar se ka hyrë në shtëpinë e J.. Kurse, bazuar në këtë rrethana rezulton se tek të dy palët ka qenë dëshira që t'i qerojnë hesapet fizikisht në mes veti, andaj, të dy palët konsiderohen si sulmues dhe të sulmuar. Prandaj, gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar edhe kërkesën e mbrojtësit të të akuzuarit F. për ekspertizë psikiatrike, ngase në

kuadër të kësaj gjendje faktike pavarësisht faktit se në rigjykim i akuzuari F. e ka pranuar faktin se e ka goditur të ndjerin me një hu druri të trashë nuk mund të pretendohet se veprimet e të akuzuarit F. ishin të lejuara apo të ndërmarra për ta zmburps sulmin e kundërligjshëm dhe të atëçastshëm prej vetës apo tjetrit apo se pa fajin e vet është sjell në gjendje të tronditjes psikike.

Është evidente se dëshmitarë të kësaj çështje janë familjarët e të ndjerit dhe të akuzuarve, dhe se gjykata përkitazi me vërtetimin e përgjegjësisë penale të të akuzuarve E. e A. ua ka falur besimin dëshmisë së familjareve të të ndjerit, dhe se këta dëshmitar nuk kanë pas konsekuencë në të gjitha fazat e procedurës përkitazi me mjetet të cilat i kanë përdorur të akuzuarit, mirëpo, këta dëshmitar kanë qenë konsekuent sa i përket faktit se i ndjeri është goditur nga këta të akuzuar. Po ashtu, është evidente se dëshmitarët familjar të të akuzuarve E. e A. në deponimet e tyre e ngarkojnë vetëm të akuzuarin F. duke mohuar goditjet e të akuzuarve E. e A. ndaj të ndjerit, madje disa prej tyre duke mohuar jo vetëm pjesëmarrjen e tyre në ngjarje por edhe të tjerëve (J.K.), mirëpo, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur këtyre dëshmitareve nuk ua ka falur besimin sa i përket mos inkriminimit të të akuzuarve E. e A. ngase del qartë se këta dëshmitar kanë dashtë tua lehtësojnë pozitën këtyre të akuzuarve. Mirëpo, pavarësisht kësaj në kontekst të vlerësimit të gjithmbarshëm të provave të administruara - veçanërisht dëshmisë së bashkëshortes se të ndjerit, dëshmitares K. K., listës së dëshmimeve, ekspertizës mjekoligjore nga grupi prej tre eksperteve nga e cila rezulton se behet fjalë për dy plagë vdekjeprurëse të shkaktuara nga veprimi i mjeteve të forta mbretëse, pa maje dhe jo të mprehta nga më shumë se një goditje, kjo Gjykatë vlerëson se nuk janë të bazuara pretendimet e mbrojtësve të të akuzuarve E. e A.Z. se konkludimet e Gjykatës së shkallës së parë bazuar në provat e administruara përkitazi me përgjegjësinë penale të të mbrojturve të tyre janë të gabuara.

Ndërsa, meqë të akuzuarit F., E. e A. gjatë përleshjes fizike i kanë përdorur mjetet me përfaqësisht të përshkruara në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë duke e goditur të ndjerin në pjesë vitale të trupit – kokë, pa mëdyshje del se dashja e të akuzuarve ka qenë e orientuar në privimin nga jeta e të ndjerit B. K..

Pra, duke pasur parasysh gjendjen faktike e cila është përshkruar në tërsi me ketë aktgjykim dhe arsyet e lartcekura kjo Gjykatë i vlerëson si të pabazuara edhe pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit F. se në veprimet e të mbrojturit të tij qëndrojnë elementet e veprës penale të pjesëmarrjes në rrahje, nga neni 155 të KPK, kurse ato të mbrojtësve të të akuzuarve E. e A. se në rastin konkret kemi të bëjmë vetëm me lëndim të rëndë trupor me pasojë vdekje të shkaktuar nga ana e të akuzuarit F. ndaj të ndjerit.

Nga arsyet e lartcekura del i drejtë konkludimi i Gjykatës së shkallës së parë se në veprimet e të akuzuarve përmbushën të gjitha elementet e veprës penale të vrasjes nga neni 146 të KPK, pra, drejt janë aplikuar dispozitat e ligjit penale.

c. pretendimet sa i përket vendimit për dënim

Përfaqësuesi i autorizuar i palëve të dëmtuara pretendon se dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve janë të buta dhe se me to nuk do të mund të arrihet qëllimi i dënimit. Kështu, sipas ankesës gjykata është dashtë të vlerësoj si rrethana rënduese faktet se i ndjeri është vlarë para shtëpisë së tij, para syve të bashkëshortes, vëllezërve, motrës dhe prindërve të tij, afërsinë e shumëfishte të të akuzuarve me të ndjerin, faktin se kemi të bëjmë me vepër penale

kundër jetës dhe trupit ku është shuar jeta e në bashkëshorti, i cili ka lenë bashkëshorten dhe djalin e tij të vogël. Kurse, mbrojtësi i të akuzuarit F.Sh. pretendon se duke pasur parasysht ecurinë si është zhvilluar ngjarja – faktin se i akuzuari e ka parë babin e tij të përgjakur dhe vet ka qenë i sulmuar dënimi i shqiptuar është i ashpër veçanërisht në raport me të akuzuarit tjerë. Ndërsa, Meqë, sipas mbrojtësve të të akuzuarve E. e A.Z. aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal dënimi i shqiptuar me burgim ndaj të akuzuarit është i kundërligjshëm.

Duke e vlerësuar vendimin për dënim dhe pretendimet ankimore në këtë drejtim kjo Gjykatë gjen se në rastin konkret nuk vend që të akuzuarve tu shqiptohet dënim me i ashpër respektivisht me i butë. Gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform dispozitës së nenit 73 të KPRK me ç'rast i ka marrë në konsiderim rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit dhe si rrethana lehtësuese për të tre të akuzuarit ka vlerësuar faktin se kanë pas qëndrim korrekt në gjykatë, se janë familjar dhe mbajtës të familjes, kurse si rrethana rënduese ka vlerësuar rrezikimin dhe dëmtimin e e vlerës së mbrojtur – faktin se kemi të bëjmë me vepër penale kundër jetës dhe trupit është shuar jeta e një personi të ri, baba i një fëmije, përdorimin e mjeteve për kryerjen e veprës penale, gatishmërinë e të akuzuarve që t'i ndërmarrin veprimet e tilla, se vepra penale është kryer në vend publik.

Përkundër faktit se disa nga rrethanat rënduese të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë nuk mund të merren si rrethana rënduese (rrezikimi dhe dëmtimi i vlerës së mbrojtur, fakti se kemi të bëjmë me vepër penale kundër jetës dhe trupit- ka humbur jetën një personi i ri) ngase kanë ndikim me rastin e matjes së dënimit, megjithatë kjo Gjykatë vlerëson se dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve janë adekuat me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, dhe se me to do të mund të ndikohet në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tyre, por edhe në parandalimin e të tjerëve nga kryerja e veprave penale, respektivisht do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozita përkatëse ligjore.

Nga sa u tha dhe u analizua më lartë në kuptim të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË
PAKR.nr.490/2016, me 10 nëntor 2016

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
1. Fllanza Kadiu

Anëtarët e kolegjit:

2. Mejreme Memaj

3. Hava Haliti

